



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

VENDIM

Nr.....51 Datë 24 . 04 . 2019

“PËR DHËNIEN E KOMPENSIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE PER NDIHMEN EKONOMIKE PER PERIUDHEN 01-31 MARS 2019 DHE PAGESEN E P.A.K.PËR PERIUDHËN 01- 30 PRILL 2019”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015 datë 17.12. 2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” , ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, të VKM-së nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, , i ndryshuar, VKM nr. 277 dt. 18. 06 1997 “ Për përfitimet nga statusi i të verbrit” ,VKM nr. 869 datë 18.06.2008 për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Statusi i Invalidit”, VKM nr. 816 dt. 07. 09. 2006 " Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar" i ndryshuar, VKM nr. 78 dt. 07. 02. 2007 " Për masën , kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjeno-sanitare për paraplegjikët dhe tetraplegjikët" , VKM nr.565 dt. 09. 08.2006 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar, VKM nr. 404 dt. 20. 06. 2012 " Për përcaktimin e kriterëve të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse", VKM nr. 8 datë 14. 01. 2015 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për heqjen e fashës deri 300 KWH në muaj", VKM nr.376, datë 11.06.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 787, datë 14.12.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike” i ndryshuar si dhe udhëzimeve respektive në zbatim të tyre, nga materiali i paraqitur nga Drejtoria e Sherbimeve Sociale ,Këshilli I Bashkisë :

VENDOSI:

Miratimin e dhënies së kompensimit të energjisë elektrike për familjet në ndihmë ekonomike për periudhën Mars 2019

Nr.	Bashkia Lezhë/Njësitë	Kompensim i energjisë elektrike	
		Nr. i fam.	Fondi/ Lekë
1	LEZHË	18	27 048
2	SHENKOLL	91	118 496
3	KALLMET	23	29 624
4	ZEJMEN	63	149 408
5	BALLDRE	62	77 280
6	SHENGJIN	11	14 168
7	UNGREJ	10	12 880
8	DAJÇ	23	29 624
9	KOLSH	80	108 192
10	BLINISHT	10	12 880
	TOTAL	391	579 600